

Fjala e mbajtur në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës

(me rastin e pranimit anëtar i Akademisë)

Më lejoni të them dy fjalë zemre për këtë rast unik në jetën time.

Jeta e çdo njeriu ka ditë të veçanta, mbi të cilat është e papushtetshme mbretëria e harresës. Një e tillë është për mua kjo e sotmja. Dhe kjo ditë është e mbushur me kujtime, me mirënjohje, me falënderime, me premtime.

Kujtimet e para për këtë pjesë të Atdheut kanë qenë shumë të trishtuara. Për arsye që dihen, kam mundur të shkel në këtë tokë të bekuar vetëm në shekullin XXI në vitin 2001, menjëherë mbas luftës së vetme që njohu e gjithë Europa që nga lufta e dytë botërore. Dhe dita e sotme më bën të kujtoj vizitën e parë në Kosovën martire, të shkatërruar e të shkrumbuar nga lufta, me shtëpitë e djegura të Gjakovës e me rrenoja përgjatë gjithë rrugës deri në Prishtinë. Por çdoherë që kam ardhur në vitet në vijim, kam parë ndryshimet e mëdha, ndërtime, njerëzit e lirë, që më ofruan kurdoherë miqësi e mikpritje, dashuri e respekt. Jua them me sinqeritetin tim më të plotë, se me përjashtim të Shkodrës, vendlindjes sime, nga të gjitha vendet e Shqipërisë dhe të trevave shqiptare, qyteti ku kam ardhur më shpesh dhjetëvjeçarim e fundit, ku kam gjetur më shumë bujari e ngrohtësi, është Prishtina, që tashmë është e pandarë nga puna ime. E sot, kur Akademia e Shkencave më bën pjesë të saj, e ndiej më shumë se kurrë afërsinë me këtë copë të Atdheut, me të cilën s'patëm kurrë kufij natyrorë, ndërsa kufijtë e vendosur nga njerëzit janë gjithnjë të përkohshëm, se Atdheu i shqiptarëve është i pandashëm. Prandaj e ndiej për detyrë të falënderoj nga zemra të gjithë akademikët që pranuan të jem pjesë e tyre, miq prej vitesh e dashamirë të punës sime, me të cilët kam ndarë çaste të bukura sa herë jam takuar me ta, në Kosovë e në Shqipëri.

Por anëtarësimi në këtë akademi, përveçse nder e mirënjohje, është edhe premtim për punë. Ndërmjet dy pjesëve të Atdheut tonë ka shumëçka për të bërë. Le të jetë shkenca, kultura, arsimit, arti, fjala e lirë, gjuha e gjithçka që ka krijuar ky popull bashkërisht, simboli i bashkimit të Atdheut të copëzuar pa dëshirën e shqiptarëve. Kosova e Shqipëria le të jenë si dy krenët e shqiptonjës së flamurit tonë kombëtar, me një trup të vetëm, me një shpirt, me një zemër, që rreh në të gjithë trupin, me gjakun që qarkullon në të dyja anët. Le të jetë bashkimi, rruga jonë. Ndasitë e përçarjet le t'ua lëmë atyre që i krijuan.

U lutem kolegëve akademikë të mos ngurrojnë për të kërkuar angazhimin tim në punët e përbashkëta për të njësuar mendjet e zemrat tona, se angazhimi im do të jetë i plotë për çdo detyrë të ngarkuar, për çdo thirrje të tokës shqiptare në të dy anët e kufirit të saj, se titulli që jepet sot është jo vetëm nder e respekt, por në radhë të parë angazhim pune.

Falënderoj të gjithë të pranishmit që u ndodhët në këto çaste gëzimi të paharrueshëm, në këtë ditë në shenjë të jetës sime.

Kolec Topalli